

# Përtej numrave



Performanca e Prokurorisë  
në luftën kundër korrupsionit

Prill 2017

# Përtej Numrave

## Performanca e Prokurorisë në luftën kundërkorrupsionit\*

**Prill 2017**

---

\* Raporti është statistikor. Statistikat janë të kontrolluara dhe të vërtetuara. Statistikat në këtë raport janë statistika zyrtare, të dalura nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.



## **Përtej Numrave**

Performanca e Prokurorisë në  
luftën kundër korrupsionit

# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	6
Hyrje.....	7
Informata për projektin.....	11
Gjykatat.....	12
Prokuroria.....	12
Vizitat në gjykata dhe prokurori - Memorandumet.....	13
Metodologjia.....	14
Prezantimi i të gjeturave.....	20
Prokuroritë Themelore – të dhëna për të gjitha prokuroritë.....	20
Analiza e Numrave .....	30
Fluksi i lëndëve.....	31
Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR).....	32
Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2016.....	34
Norma e qarkullimit të lëndëve (DT).....	35
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (anglisht Disposition Time -DT).....	36
Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	37
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (anglisht Disposition Time -DT).....	38
Norma e zgjidhjes së lëndëve (për persona) për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale.....	39
Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e vitit 2016 për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe Prokurorinë Speciale (për persona).....	40
Norma e qarkullimit të lëndëve për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe Prokurorinë Speciale (për persona).....	42
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (Disposition Time -DT) për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale.....	43
Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale (për persona).....	44
Përfundim.....	50
Biblografia.....	52
Shënimet për prokuroritë.....	54

# Përmbledhje ekzekutive

Korrupsioni në Kosovë është cilësuar si endemik nga Komisioni Europian në Raportin e Progresit. Luftimi i korrupsionit është kërkesa kryesore e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë për t'i hapur rrugë progresit shoqëror. Prokuroria e ka punën kryesore në hetimin e korrupsionit në çdo nivel, posaçërisht në nivel të lartë që mbetet shqetësimi kryesor i shoqërisë civile dhe i bashkësisë ndërkombëtare.

Ky raport pasqyron përkushtimin e institucioneve të drejtësisë në luftimin e korrupsionit duke analizuar statistikën e kundërkorrupsionit, të publikuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).

Raporti mat performancën e Prokurorisë në luftën kundërkorrupsionit për vitin 2016. KPK-ja publikon vazhdimisht statistikën për Prokuroritë duke kontribuar në transparencën e punës së Prokurorisë. Në këtë raport Lëvizja FOL i bën një analizë këtyre numrave duke i bërë ato më kuptimplotë.

Metodologjia nga Komisioni Europian për Efikasitetin e Drejtësisë është përdorur pjesërisht për t'i analizuar numrat. Të gjeturat tregojnë se prokuroria ka një performancë të mirë në luftën kundërkorrupsionit në përgjithësi për vitin 2016, por numri i lartë i lëndëve të grumbulluara në disa rajone vazhdon të vonojë drejtësinë në disa Prokurori.

Prokuroria e Prishtinës ka numrin më të madh të lëndëve të grumbulluara, por njëkohësisht ka treguar performancë tejet të mirë në menaxhimin e fluksit të lëndëve dhe reduktimin e lëndëve të grumbulluara. Në njërën anë, raporti synon t'i shërbejë Prokurorisë në përmirësimin e performancës në luftën kundërkorrupsionit ndërsa në anën tjetër ajsynon t'u shërbejë qytetarëve për ta kuptuar më mirë punën e Prokurorive dhe përpjekjen e tyre për ta luftuar korrupsionin.

# Hyrje

Korrupsioni i thyen rregullat e drejtësisë dhe u jep disa njerëzve avantazhe që të tjerët nuk i kanë. Ka pak dëshmi se vendet mund t'i ikin mallkimit të korrupsionit me lehtësi, apo në tërësi. (Uslaner, 2008)

Kosova nuk bën ndonjë përjashtim. Përkundër dëshirës së madhe për të qenë të lirë dhe për të ndërtuar një shoqëri demokratike, të lirë prej korrupsionit, ai u shfaq paralelisht me krijimin dhe zhvillimin e institucioneve të pavarura në Kosovë. Sa më shumë që barteshin përgjegjësitë nga ndërkombëtarët tek vendorët, aq më shumë shtohet niveli i korrupsionit dhe lakmia e pushtetarëve për pasurim të shpejtë.

Ç'është e vërteta, luftimi dhe parandalimi i korrupsionit mbeten sfidat kryesore për shoqërinë e Kosovës.

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar është lloji më i përhapur i korrupsionit sipas të gjeturave të këtij raporti. Kushtëzimi i shërbimeve publike nga zyrtarë shtetërorë për përfitime personale, keqpërdorimi i pozitës zyrtare për përfitim personal, ushtrimi i ndikimit nga pozita zyrtare për kushtëzim të bizneseve për pasurim të paligjshëm janë të gjitha vepra korruptive të cilat pengojnë sundimin e ligjit dhe rrënojnë besimin në institucione.

Perceptimi i lartë i pranisë së korrupsionit në institucione publike bën që qytetarët t'i varin shpresat tek prokuroria dhe gjykatat, si institucionet vetme dhetë fundit për të gjetur drejtësi dhe për t'i ndëshkuar të korruptuarit. Janë fillimisht prokurorët e pavaruar dhe profesionalë ata të cilët kanë guxim ta hetojnë korrupsionin në cilindo nivel dhe pastaj gjyqtarët të cilët e ndajnë drejtësinë dhe vendosin nëse ligji është i barabartë për të gjithë.

Por, prokuroria është ndër institucionet në të cilat qytetarët besojnë më së paku, sipas pulsit publik të publikuar nga UNDP-ja. Për vitin 2016, rreth 20% e qytetarëve shprehën kënaqshmëri me punën e Prokurorisë (UNDP - Kosovë, 2016, fq. 4,8).

Prania e madhe e korrupsionit në shoqëri bën që të bie besimi në të gjitha institucionet e shtetit, e në veçanti në ato të drejtësisë.

Komisioni Europian në Raportet e Progresit vazhdimisht ka dhënë alarmin për prani të madhe të korrupsionit në Kosovë, duke alarmuar se ai është duke u kthyer në sëmundje (Komisioni Europian, 2015, fq. 6).

Duke pasur fuqinë e kushtëzimit në procesin integruar, BE-ja vendosi kritere të qarta për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, ku ndër kryesoret ishte dëshmia me numra (Komisioni Europian, 2016) nga Prokuroria në hetimin e korrupsionit të nivelit të lartë.

Kjo pati ndikim, pasi përpjekjet e Prokurorisë për të treguar performancë shihen edhe në këtë raport.

Megjithatë, sistemi i drejtësisë vuan vetë nga i njëjti sindrom, pra nga korrupsioni. Kjo është konfirmuar nga Komisioni Europian cili vëren se sistemi i drejtësisë është i prekur nga korrupsioni dhe nga ndikimi politik dhe ka mungesë të besimit të qytetarëve (Komisioni Europian, 2016). Të njëjtat shqetësime ndajnë edhe Departamenti Amerikan i Shtetit dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe vendore (Departamenti i Shtetit, 2015).

Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorisë është thelbësore për funksionimin e një shteti demokratik. Besimi i qytetarëve se ata nuk do të jenë subjekt i përndjekjes nga prokurorë të ndikuar nga politika dhe korrupsioni, apo nga prokurorë që ndjekin interesa të caktuar, besimi i bizneseve se ato nuk përndiqen nga prokurorët pa dëshmi të bazuara vetëm për ta eliminuar konkurrencën e grupeve të lidhura me prokurorë, dhe besimi i aktivistëve dhe politikanëve se ata nuk do të përndiqen nëse flasin hapur kundër pushtetit, janë jetike për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Rritja e besimit në institucionet e drejtësisë është proces që vazhdimisht duhet ndërtuar dhe përmirësuar.

Hapi i parë padyshim është rritja e kritereve të shkëlqyeshmërisë që mundëson që prokurorët të jenë profesionalë dhe me integritet\*.

Hapi i dytë është ngritja e përgjegjësisë dhe transparencës. Çdo vit, gjykatat hedhin një numër të madh aktakuzash si të pabazuara, kryesisht për shkak të mungesës së profesionalizmit por edhe të ndikimit të grupeve të interesit dhe politikës, të lidhura me prokurorë të caktuar. KPK-ja ka për detyrë t'i

---

\* Lëvizja FOL është duke skanuar sektorë të ndryshëm për të vlerësuar nivelin e integritetit në dy vitet e fundit. Në vitin 2017 skanimi të integritetit do t'i nënshtrohen edhe gjyqtarët dhe prokurorët.



shkëpusë lidhjet e prokurorëve me grupet e interesit duke monitoruar punën e tyre.

Transparenca nënkupton që aktakuzat e prokurorëve të jenë të hapura për publikun e gjerë, për studiuesit e ligjit, për avokatët, për mediat dhe shoqërinë civile.

Shërbimi prokurorial ende konsiderohet ndër sektorët më sekretë të shoqërisë. Statistikat janë të papërpunuara dhe të pakuptueshme dhe dekuarajuese për ata që e monitorojnë këtë sektor (Komisioni Europian, 2016).

Lëvizja FOL vazhdimisht punon për ta rritur transparencën e institucioneve publike, duke përfshirë edhe Prokurorinë. Publikimi i këtij raporti me statistika për punën dhe performancën e Prokurorisë është një hap më shumë në këtë drejtim.

Raporti hedh dritë jo vetëm mbipunën e Prokurorisë në fushën ekundërkorrupsionit, që besojmë se do t'i shërbejë vetë Prokurorisë për t'u përmirësuar, por ai edhe fton qytetarët që të njoftohen me punën e shërbimit prokurorial, duke ndikuar në rritjen e besimit dhe krijimin e një perceptimimë real.

Vetë Prokuroria ka bërë pak punë që të përmirësojë imazhin e vet. Duke qenë e kritikuar për mungesë performance janë ngritur shumë aktakuza, e një numër i madh i tyre janë hedhur poshtë nga gjykatat si të pabazuara\*.

Ne besojmë se ky raport do t'i ndihmojë së vërtetës.

Raporti është dëshmi se Prokuroria është duke u munduar ta japë kontributin e vet në luftën kundër korrupsionit përkundër mungesës së besimit në të.

Lëvizja FOL është e gatshme t'i bëjë jehonë suksesit të Prokurorisë, njëjtë siç është e përkushtuar ta kritikojë atë për dështimet. Ne jemi aleatë me të gjitha institucionet që angazhohen për qeverisje të mirë dhe transparente; për ta rritur liritë e qytetarëve; për ta zhvilluar ekonominë, për ta forcuar demokracinë dhe për tapërmirësuar mirëqenien.

---

\* Vetëm në vitin 2016 rreth 207 persona janë raportuar se janë zgjidhur "në mënyrë tjetër". Nga intervistat me zyrtarë të statistikave në KGJK por edhe me Kryetarë të gjykatave është konfirmuar se në këtë numër, pjesa më e madhe është për aktakuzat e hedhura"

Por, për ta ndihmuar Prokurorinë dhe çdo institucion tjetër në Kosovë, ne kemi nevojë që ato të hapen për publikun, pasi jemi të bindur se transparenca është hapi më i rëndësishëm për të zbuluar të vërtetën dhe për t'i rralluar perceptimet e gabuara.

Natyrisht se transparenca nuk është ilaç për të gjitha problemet që kanë institucionet, por ajo do të ndikojë që puna dhe mospuna e tyre të shihet nga qytetarët.

Raporti është statistikor, dhe është i bazuar në statistikat zyrtare të KPK-së. Si i tillë, ai nuk mund të kuptojë nëse Prokuroria ka bërë punë profesionale dhe të pavaruar apo të pandikuar nga grupet e interesit dhe nga politika. Për të bërë një analizë të tillë do të duhej të analizoheshin lëndë konkrete në tërësinë e tyre.

Ky raport është një përpjekje për ta rritur transparencën në sektorin e drejtësisë dhe për ta shtuar ndikimin në ngritjen e performancës së Prokurorisë në luftmin e korrupsionit.

Pjesa e parë e raportit jep informata për donatorët dhe projektin duke vazhduar me prezantimin e metodologjisë. Më pas prezantohen të gjeturat duke përdorur statistikat zyrtare të KPK-së, bëhet një analizë e këtyre numrave duke përdorur metodologjinë e CEPEJ-it si dhe jepet përfundimi.

Ne besojmë fuqishëm se raporti do të mundësojë që vetë Prokuroritë të adresojnë problemet e efikasitetit në punën e tyre, duke kontribuar në ngritjen e performancës në përgjithësi.

Ne të gjithë përfitojmë nga një shërbim prokurorial i pavaur, profesional dhe efikas si dhe nga prokurorë me integritet.

# Informata për projektin

Në shtator 2016, Lëvizja FOL ka marrë mbështetje në formë të grantit institucional nga programi ‘Promovimi i Shoqërisë Demokratike’ (DSP) i mbështetur nga Zyra Zvicrane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO–K), Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmes këtij granti institucional, Lëvizja FOL për 20 muaj do të monitorojë punën e Prokurorisë dhe gjykatave si dhe do të masë performancën e tyre në luftën kundër korrupsionit\*.

Rezultatet që pritet të arrihen me këtë grant janë; a) ndikim i shtuar në rritjen e performancës së institucioneve zbatuese të ligjit në Prokurori dhe gjykata për të parandaluar, për të hetuar dhe për të gjykuar rastet korruptive si dhe b) ndikim i shtuar në përmirësimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik për efektivitet dhe efikasitet më të lartë, si dhe ndikim në uljen e korrupsionit në prokurimin publik.

Në kuadër të projektit, Lëvizja FOL do të ndërmarrë, mes tjerash, këto aktivitete: **a)** *Monitorim i gjykatave dhe Prokurorive Themelore në lëndët e nivelit të lartë të korrupsionit, matja e performancës dhe efikasitetit të gjykatave dhe Prokurorive Themelore në lëndët e korrupsionit, organizimi i tryezave për punën e gjykatave dhe Prokurorive në lëndët e korrupsionit;* **b)** *Monitorimi i ligjit për prokurim publik dhe raporte periodike në baza tremujore në lidhje me procesin e implementimit të prokurimit elektronik, tryeza të rregullta në baza gjashtëmujore për implementimin e prokurimit elektronik në Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Bujqësisë, publikim i raporteve përfundimtare për monitorimin e Strategjisë dhe legjislacionit relevant në fushën e Prokurorisë dhe gjykatave si dhe prokurimit publik.*

---

\* Gjqësori është vetëm njëra pjesë e monitorimit. Me të njëjtin grant, Lëvizja FOL do të monitorojë për 20 muaj edhe prokurimin publik në tri ministri. [http://www.kcsfoundation.org/dsp/repository/docs/Grant\\_institucional\\_DSP\\_II\\_GI\\_-\\_10\\_zbatuar\\_nga\\_Levizja\\_FOL-ENG.pdf](http://www.kcsfoundation.org/dsp/repository/docs/Grant_institucional_DSP_II_GI_-_10_zbatuar_nga_Levizja_FOL-ENG.pdf)

## Gjykatat

Projekti është i fokusuar në gjykata dhe në prokurori themelore. Gjykatat të cilat janë pjesë e monitorimit të këtij projekti janë gjykatat themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan. Projekti do të masë performancën e gjykatave në fushën e kundërkorrupsionit përmes një metodologjie nga Komisioni European për Efikasitetin e Drejtësisë. Performanca do të matet duke shfrytëzuar statistikat që dalin nga vetë gjykatat por edhe dokumentet tjera, siç është Strategjia Kundër Korrupsionit 2013 – 2017\*.

Kjo strategi ka katër objektiva në kuadër të zbatimit të ligjit. Dy nga këto objektiva: **1)** Rritja e nivelit të efikasitetit të institucioneve zbatuese të ligjit në prokurori dhe gjykata, për të parandaluar, hetuar dhe gjykuar lëndët korruptive dhe **2)** Rritja e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të institucioneve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave, do të jenë pjesë e monitorimit nga Lëvizja FOL. Monitorimi do të bëhet për pjesët e aktiviteteve dhe afateve të cilat vazhdojnë deri në 2017. Një vlerësim i strategjisë për të gjitha objektivat dhe aktivitetet në fushën e korrupsionit do të bëhet në gjashtëmujorin e fundit të vitit 2017, kur edhe përfundon strategjia. Këshilli Gjyqësor gjithashtu ka hartuar plan strategjik në vitin 2013 me titull “Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra (KGJK 2013)”\*\*. Nga kjo strategji, në raportet e ardhshme, FOL do të masë pjesën e përkushtimit të gjykatave në reduktimin e lëndëve të korrupsionit.

## Prokuroria

Tek prokuroria, projekti do të monitorojë dhe masë performancën bazuar në statistikat e vetë prokurorive. Prokuroritë themelore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan do të jenë pjesë e matjes së performancës dhe monitorimit. Përveç strategjisë kundërkorrupsionit 2013-2017, Prokuroria e Shtetit ka hartuar një strategji me titull “Prioritetet e Prokurorive Themelore në Kosovë në ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe reduktimin e numrit të

---

\* Në Shkurt ka filluar punën grupi i ri punues për hartimin e strategjisë së re Antikorrupsion. Në këtë raport nuk do të ketë matje të përmbushjes së objektivave nga strategjia antikorrupsion 2013-2017.

\*\* Në këtë raport nuk është përfshirë matja e arritjes së objektivave në përmbushjen e strategjisë për reduktimin e lëndëve.

lëndëve”\* e cila do të jetë pjesë e monitorimit. Kjo strategji prioritetin e parë e ka: “Veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe të gjitha veprat tjera ku mund të aplikohet konfiskimi”(Prokurori i Shtetit 2015).

## **Vizitat në gjykata dhe prokurori - Memorandumet**

Në kuadër të projektit do të bëhen vizita të rregullta në gjykatat dhe prokuroritë themelore.

Në nëntor, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe institucioneve të drejtësisë, është realizuar takimi me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z.Nehat Idrizi ku është njoftuar me projektin dhe aktivitetet e projektit. Si rezultat, me 30 janar 2017 është nënshkruar Memorandumi Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ky memorandum ka për qëllim bashkëpunimin reciprok ndërmjet Lëvizjes FOL dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për monitorimin e zbatimit të ligjit në gjykimet e rasteve të kundërkorrupsionit, zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit dhe monitorimin e keqpërdorimeve në shpenzimin e parasë publike. FOL do t’i ofrojë bashkëpunim profesional KGJK-së për arritjen e qëllimeve të përbashkëta për interesin e gjyqësorit dhe publikut.

Në dhjetor 2016 është mbajtur takimi me Koordinatorin e Mekanizmave Përcjellës për Shënjestrimin e Lëndëve të Kundërkorrupsionit, z.Agim Maliqi. Takimi ka ndihmuar në përmirësimin e statistikave të kundërkorrupsionit për gjykata. Z. Maliqi gjatë takimit na njoftoi për një strategji të cilën e implementojnë bashkë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e cila ka të bëjë me reduktimin e lëndëve të kundërkorrupsionit në gjykata. Në kuadër të aktivitetit - vizita në gjykata dhe prokurori themelore të Kosovës, është vizituar Gjykata Themelore në Ferizaj kurse në shkurt është vizituar Gjykata Themelore në Gjiilan. Memorandumi me KGJK-në ka thelluar bashkëpunimin me gjykatat themelore, duke kontribuar në zvogëlimin e barrierave të komunikimit dhe shkëmbimin më të lehtë të informatave.

---

\* Në këtë raport nuk është përfshirë matja e arritjes së objektivave në përmbushjen e kësaj strategjie.

FOL do të masë gjithashtu edhe performancën e prokurorëve dhe gjyqtarëve në shtatë gjykatat dhe prokuroritë themelore.

Matja është kryesisht statistikore dhe nënkupton numrin e lëndëve për prokurorë/gjyqtarë në prokurori/gjykata themelore për periudhën kohore 2016-2018.

# Metodologjia

Duhet të theksojmë që në fillim se matja e performancës së Prokurorisë nuk është punë e lehtë. Për dallim nga gjyqësori, puna e të cilit matet me lëndë, puna e Prokurorisë matet kryesisht me persona. Kjo sepse Prokuroria investon kohë të gjatë në përgatitjen e një lënde për një person.

Natyrisht, hetimi nuk është i njëjtë dhe ai ndryshon varësisht prej veprës penale për të cilën hetohet dhe varësisht se sa kompleks është rasti. Të gjitha këto dhe shumë të tjera ndikojnë në trajtimin e një rasti si dhe në kohëzgjatjen e tij deri në shndërrimin e tij në aktakuzë.

Siç u pa nga raporti për gjykatat, për matjen e performances së gjyqësorit Lëvizja FOL ka përdorur formulat e Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) (CEPEJ, 2015). Vetë CEPEJ-i nuk ka bërë matjen e efikasitetit të shërbimit prokurorial\*.

Megjithatë, pas analizës, FOL ka arritur në përfundim se formulat nga CEPEJ-i për gjykatat janë të përdorshme edhe për matjen e efikasitetit të Prokurorive mbi bazën e statistikave zyrtare.

Matja nuk përfshin gjithë sistemin prokurorial dhe nuk përfshin të gjitha lëndët dhe llojet e veprave. Matja bëhet vetëm për një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht për Kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437\*\*.

Matja nuk tregon për cilësinë e lëndëve dhe cilësinë e punës së prokurorëve, cilësinë e shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin e prokurorëve.

Fushat në të cilat FOL do ta masë performancën e Prokurorisë janë si në vazhdim: 1) Fluksi i lëndëve, 2) norma e zgjidhjes së lëndëve, 3) norma e qarkullimit të lëndëve, 4) trendi i zgjidhje së lëndëve, 5) kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve dhe 6) indeksi i lëndëve të grumbulluara.

---


\* Lëvizja FOL ka kontaktuar me Adis Hodzic-in – këshilltar i lartë për statistika, sekretariati i lartë i Gjykatave dhe Prokurorisë, Këshilli i Bosnje dhe Hercegovinës, ekspert i BE-së. Përgjigja nga Hodzic-i është se kjo çështje do të diskutohet në takimin e radhës të CEPEJ-it në maj. FOL nuk ka gjetur asnjë publikim nga CEPEJ-i për matjen e prokurorive.

\*\* Shiko Tabelën 1: Kodi Penal i Kosovës. Kapitulli XXXIV – Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

# Fluksi i Lëndëve

Fluksi i lëndëve është tregues i rendësishëm që tregon se me çfarë fluksi përballen Prokuroritë dhe si e menaxhojnë ato këtë fluks. Kjo përfshin lëndë të reja, lëndë të zgjidhura dhe lëndë në pritje të zgjidhjes. Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë veprim nga prokurorët, numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjia që jep sistemi i Prokurorisë, pra, numri i lëndëve që trajtohen\*. Lëndët që priten të trajtohen janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga Prokuroria apo prokurori, në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten. Në këtë pjesë ne nuk i përfshijmë në matje institucionet që dërgojnë lëndë në Prokurori apo nëse ato janë inicuar nga vetë prokurorët. Ne gjithashtu nuk analizojmë dhe nuk e përfshijmë në matje fazën fillestare, pra fazën e informatave para se ato të kthehen në kallëzime penale. Ne analizojmë vetëm kallëzimet penale.

## Shembull mbi njesinë matese



$$LP=PS+I : PE=LP-R$$

\* Trajtimi dhe zgjidhja mund të shërbejnë si fjalë që përmbushin njëra-tjetrën. Për gjykata përdoret fjala 'zgjidh' kurse për Prokurori 'trajton'. Kjo pasi lënda në prokurori nuk konsiderohet e zgjidhur pa një vendim të gjykatës.

\*\* Këtu e tutje, me periudhë raportuese nënkuptohet periudha brenda një viti kalendarik

## Norma e zgjidhjes së lëndëve\*

Është indikator jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse mat raportin midis lëndëve të zgjidhura (R) dhe numrit të lëndëve të reja (I). Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një Prokurorie të shprehur në përqindje duke na lehtësuar kuptimin e nivelit të përkushtimit.

$$\text{norma e zgjidhjes se lëndëve \%} = \frac{\text{rastet e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{rastet e reja gjate periudhes raportuese}} \times 100$$

### Shembull

“NUMRI I LËNDËVE PËR PERSONA, TË ZGJIDHURA GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE (01.01.2016 – 31.12.2016)”

1073

LËNDËT E REJA GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE (I) (01.01.2016 – 31.12.2016)

826

NORMA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE

129.9%

SHEMBULL: NË KËTË RAST, NËSE NUMRI I LËNDËVE NË SISTEM VAZHDON TË JETË I NJËJTË, ATËHERË ME KËTË NORMË TË ZGJIDHJES SË LËNDËVE, NIVELIZIMI DO TË ARRIHET NË VITIN 2026.

## Norma e qarkullimit të lëndëve

Mat raportin ndërmjet numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Ky raport e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor ose gjykata e zëvendëson numrin e lëndëve të ardhura.

$$\text{norma e zgjidhjes se lëndëve \%} = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}} \times 100$$

\* Clearance rate - në anglisht



## Shembull

NUMRI I LËNDËVE PËR PERSONA, TË ZGJIDHURA  
GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE (01.01.2016 –  
31.12.2016) 1073

NUMRI I LËNDËVE TË PAZGJIDHURA NË FUND TË  
PERIUdhËS RAPORTUESE (31.12.2016) 1177

NORMA E QARKULLIMIT TË LËNDËVE 0,91

NË KËTË RAST, PËR VITIN 2016 DEL QË RAPORTI I QARKULLIMIT TË LËNDËVE QËNDRON NË FREKUENCËN 0,91. SIÇ DO TË SHOHIM MË POSHTË, NJË NORMË E TILLË ËSHTË E ULËT DHE SI E TILLË E VONON DREJTËSINË DHE E NGADALËSON REDUKTIMIN E LËNDËVE TË GRUMBULLUARA.

## Trendi

Mat raportin ndërmjet lëndëve në punë dhe numrit të lëndëve të zgjidhura minus lëndët e reja. Trendi nuk është pjesë e formulës së CEPEJ-it. Kjo formulë është nxjerrë duke marrë parasysh formulat tjera. Trendi në këtë raport nënkupton performancën e Prokurorive në pastrimin e lëndëve të grumbulluara. Për ta lehtësuar matjen e trendit në këtë raport, ai këtu llogaritet duke e marrë si statike performancën e Prokurorisë në vitin 2016.

$$\text{trendi} = \frac{\text{Numri i lëndëve në punë (LP)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R)} - \text{Numri i lëndëve të reja (I)}}$$

## Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve

Është tregues i cili mat kohën e përfundimit të totalit të lëndëve. Formula merr parasysh totalin e lëndëve për një periudhë të caktuar, dhe duke u bazuar në performancën e treguar në raportin e qarkullimit të lëndëve e kthen performancën për kryerjen e lëndëve në ditë.

Ky tregues është i rëndësishëm për të parë se sa kohë merr secila Prokurori për dhënien e drejtësisë. Natyrisht matja nuk tregon për lëndët specifike pasi në realitet një lëndë mund të marrë shumë më shumë kohë se sa një tjetër, por formula merr parasysh hyrjen dhe daljen e lëndëve në sistem duke u bazuar në performancën e treguar. Kur Prokuroria e caktuar nuk ka lëndë të bartura, ajo trajton lëndët në kohë më të shkurtë duke bërë që ajo të jetë më efikase.

## Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Është indikator i cili tregon performancën e Prokurorive në përfundimin e lëndëve të grumbulluara. Numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndikon drejtpërdrejt në performancën e Prokurorive. Një vlerë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve. Sa më shumë lëndë që barten për vitin vijues, aq më shumë do të vonojë prokuroria në ngritjen e aktakuzave.

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$$

Këto janë formulat dhe ky është sistemi i vlerësimit që do të përdoren për të matur performancën e Prokurorive në këtë raport.

Ky është raporti i parë i publikuar nga Lëvizja FOL për matjen e këtij niveli të performancës, dhe si i tillë është i hapur ndaj kritikave dhe sugjerimeve. Këto të gjetura do të diskutohen dhe do të analizohen në hollësi nga Prokuroria në tryeza të përbashkëta.

## Mbledhja e të dhënave

Në baza tremujore, Lëvizja FOL në vazhdimësi mbledh të dhënat\* në fushën e korrupsionit nga gjykatat dhe Prokuroritë. Në kuadër të këtij projekti ka vazhduar mbledhja e të dhënave për grupin e të dhënave të kundërkorrupsionit, por me bazë të zgjedhur.

Në vazhdim janë të paraqitura grafikët për të gjitha llojet e veprave penale nga grupi i veprave penale: “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, Kapitulli XXXIV i Kodit Penal të Kosovës”.

\* Të dhënat janë siguruar përmes e-mailit nga zyra për statistika në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK)

Neni	Kategoria	Neni	Kategoria
422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare	431	Ushtrimi i ndikimit
424	Konflikti i interes	432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
425	Përvetësimi në detyrë	433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
426	Mashtrimi në detyrë	434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
428	Marrja e ryshfetit	436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
429	Dhënia e ryshfetit	437	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Për vitin 2016 janë marrë të dhënat nga Prokuroritë në baza tremujore dhe vjetore si më poshtë:

**TABELA 1: KODI PENAL I KOSOVËS. KAPITULLI XXXIV – KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTAR**

# Prezentimi i të gjeturave


## Prokuroritë Themelore – të dhënat për të gjitha Prokuroritë

Gjatë fazës së mbledhjes së informatave dhe statistikave, Lëvizja FOL ka kërkuar informata të përgjithshme dhe specifike në luftën kundër korrupsionit. Të dhënat e përgjithshme janë ato informata të cilat japin një pasqyrë të përgjithshme për punën e Prokurorive të cilat janë të hapura për publikun, kurse specifike janë ato informata të cilat Prokuroria i përdor për prioritete të caktuara. Për shembull, në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, Prokuroritë kanë pasur prioritet që të performojnë më mirë për të përmbushur kushtin për liberalizimin e vizave (Maliqi, 2016). Ne nuk kemi qasje në këto statistika.


Në përgjithësi, zyra për statistika në Këshillin Prokurorial të Kosovës ka qenë bashkëpunuese dhe nuk kemi pasur pengesa sa i përket qasjes në informata.

Në Tabelën 1. i kemi paraqitur të gjitha kategoritë e veprave penale në kuadër të Kapitullit XXXIV.


Në vazhdim po i paraqesim grafikët me të dhënat për secilën kategori, dhe pastaj do ta bëjmë analizën e të dhënave.




Grafiku 1




Grafiku 2




Grafiku 3




Grafiku 4




Grafiku 5



Grafiku 6



Grafiku 7




Grafiku 8




Grafiku 9






Grafiku 10




Grafiku 11

### Zbulimi i fshehtësisë zyrtare - nivel kombëtar




Grafiku 12


### Falsifikimi i dokumentit zyrtar - nivel kombëtar



Grafiku 13




Grafiku 14




Grafiku 15

Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - nivel kombëtar



Grafiku 16

Prokuroritë Themelore dhe Prokuroria Speciale  
Statistikat Antikorrupsion për Persona  
Janar-Dhjetor 2016 - nivel kombëtar



Grafiku 17

# Analiza e numrave

Lehtë humbet interesimi për numra nëse nuk e zbërthejmë domethënien e tyre.

Çka tregojnë grafikët e mësipërm për performancën e Prokurorisë në fushën e korrupsionit? A kanë punuar Prokuroritë mirë? A e kanë luftuar korrupsionin?

Ajo që vërejmë nga grafikët e mësipërm është se Prokuroritë në tërë territorin e Kosovës kanë pasur performancë të mirë në luftën kundërkorrupsionit, në kuptimin që ato kanë arritur të zgjidhin shumicën e lëndëve, në raport me numrin e lëndëve të pranuar.

Nga i gjithë grupi i veprave të korrupsionit, vepra penale e keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, është vepra që përsëritet më së shpeshti e që është edhetregues i llojit dhe i nivelit të korrupsionit në vend.

Korrupsioni zyrtar është korrupsioni i cili ushtrohet nga personi zyrtar i cili shfrytëzon shërbimin, autorizimet e tij publike në mënyrë të jashtëligjshme dhe në kundërshtim me qëllimet e shërbimit, me synim të përfitimit të dobisë si për vete ashtu edhe për personat tjerë (Kodi Penal, 2012). Në vitin 2016, Prokuroritë kanë pasur në punë 1786 kallëzime penale për persona të dyshuar për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar.

Nga këta 1786 persona, Prokuroritë kanë trajtuar vetëm 772 persona, duke bartur për vitin pasues 1014 kallëzime penale ose persona.

Edhe përkundër numrit të madh të lëndëve të trajtuara për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar (772) dhe numrit të personave për të cilët Prokuroria ka marrë veprime të caktuara ku: ka hedhur kallëzim penal (330); e ka pushuar hetimin (159), megjithatë numri i aktakuzave (283), mbetet i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të kallëzimeve penale (1786).

Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë se cilat janë arsyet që Prokuroria ka hedhur poshtë kallëzimet penale për 330 persona, apo e ka pushuar hetimin pasi kjo kërkon qasje më të detajuar në dosjet dhe informatat e Prokurorive dhe prokurorëve, por në këta numra pa dyshim që përfshihet edhe parashkrimi i veprave penale.

Në fakt, edhe gjykatat edhe Prokuroritë fshehin arsyet e vërteta të zgjidhjes së disa lëndëve. Parashkrimi duhet të raportohet pasi kjo na tregon se çka ka ndodhur me lëndë të caktuara të cilat nuk na tregojnë shumë se çka ka ndodhur.

Nëse korrupsionin e shohim nga kalëzimet penale, atëherë lehtë mund të argumentojmë se numri më i madh i atyre që janë korrumpuar në Kosovë janë zyrtarë shtetërorë dhe jo qytetarë të rëndomtë, fakt ky që përcakton formën e korrupsionit në Kosovë.

## Fluksi i lëndëve

Në vazhdim do të bëjmë analizimin e numrave përmes formulave të cilat tregojnë për kapacitetin e Prokurorive Themelore në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe performancën e tyre për vitin 2016.

Bazuar në metodën e CEPEJ-it, fluksi i lëndëve do të na tregojë se si qëndron raporti ndërmjet lëndëve të reja, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve në pritje. Siç u tha më lartë, numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që hyjnë në sistem dhe që kërkojnë trajtim; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjia që jep sistemi i drejtësisë, pra numri i lëndëve që trajtohen. Lëndët që priten të zgjidhen ose lëndët e papërfunduara janë numri i lëndëve që mbeten për t'u trajtuar nga Prokuroria në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.

$$LP=PS+I : PE=LP-R$$

(**LP** = Lëndë në Punë. **PS** =Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese. **I**=Raste të reja të hapura gjatë periudhës raportuese. **PE**=Raste të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. **R**=Raste të zgjidhura gjatë vitit kalendarik).




Tabela 2 Statistikat vjetore për Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë Speciale për vitin 2016 për veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

$$(LP) 2250 = PS 1424 + (I) 826$$

ose

$$(PE) 1177 = (LP) 2250 - (R) 1073$$

Siç vërejmë nga tabela e mësipërme, për të gjitha kategoritë në kuadër të Kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës në vitin 2016 janë bartur 1424 lëndë (për persona) nga viti paraprak (2015). Janë pranuar 826 lëndë (për persona) gjatë vitit kalendarik 2016, duke bërë që gjatë vitit 2016 Prokuroritë të trajtojnë 2250 lëndë (për persona).

Numri i lëndëve në punë (për persona) (LP) është rezultati në mes të lëndëve të pazgjidhura nga viti paraprak (PS) plus numri i lëndëve të reja të pranura gjatë vitit kalendarik raportues (I). Ndërkaq lëndë të pazgjidhura (PE) është diferenca mes lëndëve në punë gjatë vitit kalendarik (LP) dhe lëndëve të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R).

## Norma e zgjidhjes së lëndëve (CR)

### Formula (CEPEJ):

$$\text{norma e zgjidhjes se rasteve \%} = \frac{\text{lendet e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lendet e reja gjate periudhes raportuese}} \times 100$$

### Rrjedhimisht

$$\text{norma e zgjidhjes se rasteve \%} = \frac{1073}{826} \times 100 = 130\%$$





Në vitin 2016 shtatë Prokuroritë Themelore dhe ajo speciale në kuadër të Kapitullit XXXIV të Kodit Penal të Kosovës - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, kanë pranuar në punë 826 lëndë (për persona) ndërkaq kanë arritur të zgjidhin 1073 lëndë (për persona). Sipas përlllogaritjes, të bazuar në formulën e CEPEJ-it, norma e zgjidhje së lëndëve (për persona) është 130% për vitin 2016 në nivel kombëtar në fushën e kundërkorrupsionit.

Norma e zgjidhjes së lëndëve është tregues jashtëzakonisht i rendësishëm i performancës së Prokurorive sepse kjo na tregon për kapacitetin punues të Prokurorive. Bazuar në normën e përlllogaritur në vitin 2016 Prokuroria ka punuar efektivisht mbi nivelin 100%.

Norma prej 100% do të ishte e dëshirueshme sikurse Prokuroritë të mos kishin lëndë të grumbulluara. Një performancë e tillë tregon se Prokuroritë kanë zgjidhur më shumë lëndë (për persona), se sa kanë pranuar në punë për vitin 2016, që është tregues se Prokuroritë kanë arritur të zgjidhin edhe lëndë (për persona) të bartura.

Por siç do të shohim më poshtë, janë Prokuroritë e veçanta ato që përmirësojnë apo përkeqësojnë performancën e Prokurorisë në tërësi. Ne shpresojmë se ky raport do t’i ndihmojë sektorit të drejtësisë që të intervenojë në ato Prokurori ku janë evidentuar problemet për të gjetur zgjidhjet e nevojshme sidomos në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, e cila ka një performancë shumë më të dobët, krahasuar me Prokuroritë tjera.

**Nga 2250 raste, prokuroritë kanë arritur të zgjidhin 1073 prej tyre, ndërsa janë bartur për vitin 2017 gjithsej 1177 raste**

## Trendi i nivelizimit të lëndëve bazuar në performancën e vitit 2016

Një numër i madh i lëndëve vazhdojnë të barten nga viti paraprak duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Numri i lëndëve të bartura ndikon drejtpërdrejt në performancën e Prokurorisë edhe pse niveli i performancës është mbi 100%.

Nga përlllogaritja, nëse marrim për bazë normën e zgjidhjes së lëndëve të treguar për vitin 2016, Prokuroritë do të arrijnë t'i përfundojnë lëndët e bartura në vitin 2026.

$$\text{trendi} = \frac{\text{numri i lëndëve në punë (LP)}}{\text{numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}} \times 100$$

*Rrjedhimisht*

$$\text{trendi} = \frac{2250}{1073 - 826} = 9 \text{ (vjet)}$$



Formula e mësipërme merr parasysh performancën e Prokurorisë për vitin 2016 dhe formulohet mbi supozimin se për 9 vitet e ardhshme, Prokuroria do të vazhdojë të ketë normën e njëjtë të zgjidhjes së lëndëve – 130%\*.

Sa më shumë lëndë që Prokuroritë bartin për vitet pasuese, aq më e ulët do të jetë norma e zgjidhjes së lëndëve dhe aq më shumë sistemi do ta vonojë dhënien e drejtësisë\*\*.

## Norma e qarkullimit të lëndëve (DT)

Komisioni European për Efikasitetin e Gjyqësorit kërkon që sistemi i drejtësisë të raportojë një indikator të kohëzgjatjes e përfundimit të lëndëve i cili llogaritet në dy hapa. **Së pari**, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese pjestohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese\*\*\* që njihet edhe si “raporti i qarkullimit të rastit”. **Pastaj**, ky raport i qarkullimit të rastit pjestohet me 365\*\*\*\* kështu që indikator i kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve (DT) mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ-i sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që presin të zgjidhen (lëndët e bartura). DT në këtë mënyrë mat sa shpejtë sistemi i drejtësisë përfundon lëndët e pranuar në punë – që përkthehet me kohën që marrin lëndët për t’u zgjidhur (Hall & Keilitz, 2012).

---

\* Ajo që nuk mund të bëhet në këtë raport në mungesë të të dhënave është përllogaritja e trendit të zgjidhjes së lëndëve ndër vite, defekt ky që shpresojmë të përmirësohet në raportet e ardhshme.

\*\* [http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au\\_dela\\_rapport/Stawa\\_Adiz\\_general\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/thematiques/Au_dela_rapport/Stawa_Adiz_general_en.pdf)

\*\*\* Periudha raportuese i referohet periudhës në të cilën raportohen statistikat. Në rastin tonë pasi statistikat janë vjetore, periudhë raportuese është i gjithë viti kalendarik.

\*\*\*\* 365 është numri i ditëve gjatë një viti kalendarik

## Hapi i parë

### Formula

$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese}}$$

### Rrjedhimisht

$$\text{norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{1073}{1177} = 0,9$$

Norma e qarkullimit të lëndëve në nivel kombëtar për Prokurorinë për vitin 2016 qëndron në **0,9**.

Koha apo norma e qarkullimit të lëndëve na mundëson ta kuptojmë menaxhimin e fluksit të lëndëve nga Prokuroritë. Në përgjithësi, norma e qarkullimit të lëndëve dhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Norma e qarkullimit mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i Prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjidhjen e një rasti. Në mënyrë të tërthortë ky indikator i përgjigjetnjërësprej pyetjeve më të shpeshta dhe më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë, që është – sa zgjat procedura gjyqësore, në këtë rast sa zgjat procedura deri në ngritjen e aktazkuzës (Hodzic & Georg).

## Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (Disposition Time -DT)

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve është tregues i rëndësishëm për matjen e performancës së sistemit gjyqësor. DT-ja krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. 365\* pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve të gjetur në hapin e parë në mënyrë që koha të përkthehet në numrin e ditëve. Siç shpjeguam edhe më lartë, ky indikator (DT) së bashku me normën e qarkullimit tregon se si Prokuroritëe menaxhojnë fluksin e lëndëve dhe sa shpejt japin drejtësi.

Raporti i qarkullimit të rasteve për persona qëndron në

0,9

\* Numri i ditëve brenda një viti.

## Hapi i dytë

### Formula (CEPJ).

$$\text{kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{Raporti i qarkullimit të lëndëve}}$$

### Rrjedhimisht

$$\text{kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{0.9} = 405 \text{ ditë}$$

365 është numri i ditëve brenda një viti i cili pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve nga shtatë Prokuroritë Themelore dhe nga Prokuroria Speciale në Kosovë që për vitin 2016 ka rezultuar në 0,9.

405 është koha e dhënies së drejtësisë nga sistemi. Pra, koha e shprehur në numër të ditëve brenda së cilës sistemi jep drejtësinë, apo përfundon një lëndë\*.

### Indeksi i lëndëve të grumbulluara.

Njëri ndër problemet kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Prokuroritë, ashtu sikurse gjykatat, vazhdojnë të lëngojnë në këtë drejtim. Numri i lartë i lëndëve të bartura bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë pasi ata duhet të presin kohë të gjatë që sistemi të merret me lëndët e tyre dhe të japë drejtësi.

Një indikator kyç i performancës së Prokurorive është edhe numri i indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ky indikator përcaktohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, i pjestuar me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese. Një vlerë e lartë e këtij numri na tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rastit. Për shembull, nëse numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese. (Hall & Keilitz, 2012, p. 27) Shërbimi prokurorial në nivel kombëtar për vitin 2016 ka një vlerë të indeksit të lëndëve të grumbulluara prej 1.32.

Kjo vlerë është e lartë pasi ende prokuroria vazhdon të bartë lëndë të pazgjidhura.

\* Zakonisht, me përfundim të një lënde në prokurori kuptohet: përfundimi i hetimeve i cili mund të rezultojë me hedhje të kallëzimit penal, pushim të hetimeve si dhe me ngritje të aktakuzës pranë gjykatës. Në praktikë puna e prokurorit nuk përfundon edhe pas ngritjes së aktakuzës pasi që procedura penale vazhdon të zhvillohet para gjykatës deri në nxjerrjen e vendimit.

Siç mund të shihet në Tabelën 7 Gjilani ka numër rekordtë indeksit të lëndëve të grumbulluara, i cili është 0.1. Gjilani në fillim të periudhës raportuese ka pasur 17 lëndë të bartura dhe ka arritur të zgjidhë 167 lëndë gjatë periudhës raportuese. Në anën tjetër, vlerë shumë e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara raportohet në Prishtinë, e cila është 2.19.

Prishtina në fillim të periudhës raportuese ka pasur 884 lëndë të bartura kursegjatë periudhës raportuese ka arritur të zgjidhë 539 lëndë. Më 1999, autorja Maria Dakolias\* për të vendosur në perspektivë domethënien e numrave raportoi një vlerë prej 0.04 për Singaporin dhe 0.25 për Francën, vlera këto që tregonin për kohë shumë të shpejtë të përfundimit të lëndëve, krahasur me shtetet tjera si Kili që kishte një vlerë prej 1.7 ose Ekuadori me një vlerë tepër të lartë prej 7.87. (Hall & Keilitz, 2012)

## Formula

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{Numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese}}$$

## Rrjedhimisht

$$\text{indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{1424}{1073} = 1.32$$


Bazuar në statistikat e vitit 2016, shërbimi prokurorial ka vlerë të lartë të indeksit të lëndëve të grumbulluara. Ajo që duhet të ritheksohet është se ky indeks është i nxjerrë vetëm nga lëndët për Kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 – 437, bazuar në statistikat zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe si i tillë nuk përfaqëson të gjitha veprat penale.

Poashtu duhet të ritheksohet se asnjëri nga treguesit e mësipërm nuk tregojnë për kohën reale që lëndët specifike qëndrojnë në sistem derisa ato të marrin drejtësi, pasi në praktikë rastet dallojnë shumë nga njëri tjetri. Më lartë prezantuam performancën e Prokurorive në nivel kombëtar. Por si kanë qëndruar Prokuroritë Themelore veçmas? Cila Prokurori ka performuar më mirë dhe cila më dobët do të mund të shohim në statistikat në vazhdim.

\* Shih gjithashtu Maria Dakolias (1999). Court Performance around the World. World Bank Technical Paper No. 430. Washington, DC: World Bank <http://documents.worldbank.org/curated/en/1999/07/440392/court-performance-around-world-comparative-perspective>

Prokuroritë Themelore	(PS = Lëndë në fillim të periudhës, të trashëguara)	Lëndë të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	(PE Lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës)
Prishtinë	884	265	1149	539	610
Ferizaj	41	32	73	28	45
Mitrovice	159	90	249	59	190
Prizren	60	80	140	71	69
Gjilan	17	198	215	167	48
Gjakove	32	31	63	28	35
Pejë	47	90	137	97	40
Prokuroria Speciale	184	40	224	84	140

## Norma e zgjidhjes së lëndëve (për persona) për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale




Bazuar në formulën për zgjidhjen e lëndëve, një performancë e mirë për Prokurorinë është kur ajo trajton po aq lëndë sa ka pranuar gjatë periudhës raportuese. Tabela e mësipërme tregon se Prokuroria e Mitrovicës, e pasuar nga ajo e Gjilanit dhe e Ferizajt kanë pasur performancën më të dobët në raportin ndërmjet lëndëve të trajtuara të pjestuara me lëndë të reja, pasi ato nuk kanë arritur të trajtojnë aq lëndë sa kanë hyrë në sistem për 2016.

Në anën tjetër, Prokuroria Speciale, Prokuroria e Prishtinës dhe ajo e Pejës kanë pasur performancë më të mirë.

**Prokuroria Speciale dhe ajo e Prishtinës kanë pasur performancën më të mirë për vitin 2016 Prizreni Peja dhe Prishtina kanë pasur performancën më të dobët**

Në këtë raport, Lëvizja FOL nuk ka bërë krahasim të normës së zgjidhjes së lëndëve ndër vite për të parë nëse fluksi i lëndëve është i njëjtë edhe për periudhat e mëhershme\*, por nëse një trend i tillë i fluksit të lëndëve vazhdon edhe për vitin 2017, Këshilli Prokurorial i Kosovës mund dhe duhet t'i shfrytëzojë këto statistika për të menaxhuar procesin e reduktimit të lëndëve të grumbulluara në Prokuroritë me fluks më të madh të lëndëve dhe me indeksmë të lartë të grumbullimit të lëndëve.

### Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e vitit 2016 për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe Prokurorinë Speciale (për persona)



Duke u bazuar në statistikat e marra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për vitin 2016, trendi i zgjidhjes së lëndëve në nivel qendror është pozitiv në kuptimin se shërbimi prokurorial në nivel kombëtar zgjidh më shumë lëndë se sa pranon gjatë një viti. Siç është cekur më lartë, me normën e zgjidhjes së lëndëve prej 130% në nivel kombëtar, Prokuroria do të arrijë nivelizimin në vitin 2026, por ky trend i zgjidhjes dallon shumë në nivel të Prokurorive Themelore.



E shprehur në vite, Prokuroria Themelore e Prishtinës ka kohën më të shpejtë të nivelizimit të lëndëve, e pasuar nga ajo Speciale dhe nga Prokuroria e Pejës. Arsyeja qëndron në faktin se Prokuroria Themelore e Prishtinës ka trajtuar numrin më të lartë të lëndëve që ka pasur në punë gjatë vitit 2016. Prishtina ka pasur fluks të lartë për vitin 2016 e megjithatë ka trajtuar numrin më të madh të lëndëve. Nëse fluksi i lëndëve për vitin 2017 vazhdon të jetë i njëjtë, me trendin e trajtimit të lëndëve të treguar në vitin 2016, Prokuroria Speciale dhe ajo e Prishtinës do të jenë të parat të cilat do t'i përfundojnë lëndët e bartura në fushën e korrupsionit, dhe do të jenë në gjendje të ofrojnë drejtësi në afatin më të shkurtër kohor.


Performancën më të dobët në këtë tregues e ka Prokuroria Themelore (PTH) në Mitrovicë. Kjo pasi PTH e Mitrovicës ka arritur të trajtojë shumë pak lëndë në krahasim me ato që ka trashëguar dhe me lëndë të reja. Gjilani ka pasur normë të lartë të trajtimit të lëndëve, por nuk ka arritur ta përballojë fluksin e lartë të lëndëve duke i bartur ato për vitin pasues.

Ajo që është për t'u shqetësuar është trendi negativ i zgjidhjes së lëndëve. Trendi negativ i zgjidhjes së lëndëve nënkupton që Prokuroritë trajtojnë më pak lëndë se sa që pranojnë gjatë vitit kalendarik. Prokuroria me trendin më të madh negativ është Mitrovica pasi gjatë vitit kalendarik ka bartur 31 lëndë për vitin pasardhës, e pasuar nga Ferizaji me 14 lëndë.

Nëse marrim për bazë fluksin e lëndëve (lëndët e reja) dhe normën e zgjidhjes së lëndëve për vitin 2016, Mitrovica, Ferizaji, Gjilani, Prizreni dhe Gjakova nuk do të arrijnë deri në pafundësi të bëjnë nivelizimin e lëndëve, pra të trajtojnë lëndët e grumbulluara.

Kjo pasi që, për të zgjidhur lëndët e grumbulluara, këto Prokurori duhet të kenë trend pozitiv duke treguar normë më të lartë se 100% të zgjidhjes së lëndëve. Rrjedhimisht, për të gjitha prokuroritë të cilat kanë trend negativ të zgjidhjes së lëndëve, formula nuk do të jetë e aplikueshme në këtë raport.

## Norma e qarkullimit të lëndëve për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe Prokurorinë Speciale (për persona)




Prokuroria e Mitrovicës është nën nivelin e performancës me normë të qarkullimit të lëndëve prej 0.31. Kjo normë e qarkullimit të lëndëve vjen si rezultat i performancës së dobët në zgjidhjen e lëndëve të bartura. Siç vërejtëm nga fluksi i lëndëve, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar 265 lëndë dhe ka zgjidhur 539 sosh për vitin 2016, duke trajtuar kështu 274 lëndë më shumë, kurse Prokuroria Themelore në Gjilan ka pranuar 198 lëndë dhe ka zgjidhur 167 prej tyre, duke bartur 31 lëndë për vitin pasardhës.

Megjithatë, Prishtina ka normë më të ulët se Gjilani, sepse totali i lëndëve të bartura ndër vite është më i lartë se në Gjilan, duke bërë që Prishtinës t'i duhet më shumë kohë për përfundimin e lëndëve në total.

\* Sa më e madhe të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi, pra koha për përfundimin e lëndëve.

## Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve (Disposition Time -DT) për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale




Një tregues tjetër i performancës së prokurorisë është edhe kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve, që në anglisht njihet si “Disposition Time (DT)”. Ky është tregues i rëndësishëm pasi e përkthen kohën e zgjidhjes së lëndëve në ditë, duke e thjeshtuar edhe më tej kuptimin e performancës së Prokurorisë në trajtimin e lëndëve.

Në përputhje me formulën e rekomanduar nga CEPEJ-i dhe në përputhje me rezultatet e normës së qarkullimit të lëndëve shohim se Prokuroria e Mitrovicës ka performancën më të dobët me kohëzgjatje tejet të lartë të trajtimit të lëndëve në krahasim me Gjilanin dhe Pejën. Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve merr parasysh totalin e lëndëve që presin për trajtim para Prokurorive. Për shkak të normës së lartë të qarkullimit për vitin 2016, Prokuroria e Gjilanit ka kohën më të ulët se cilado prokurori tjetër në trajtimin e lëndëve.

Sa për krahasim, qytetarët e rajonit të Gjilanit, bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve për vitin 2016, mund të presin trajtimin e lëndëve në fushën e korrupsionit brenda 105 ditëve, kurse ata në rajonin e Mitrovicës duhet të presin për një periudhë prej 1175 ditëve.

## Indeksi i lëndëve të grumbulluara për shtatë Prokuroritë Themelore si dhe për Prokurorinë Speciale (për persona)



Duke pasur parasysh numrin e lartë të lëndëve të grumbulluara në përgjithësi në sistemin prokurorial, është i rëndësishëm një indikator i cili tregon performancën e Prokurorive në këtë drejtim. Ajo që vërejmë në nivel kombëtar është se indeksi i lëndëve të grumbulluara 1.32 është mjaft i lartë. Por nga vjen ky numër i lartë i indeksit të lëndëve të grumbulluara?

Duke analizuar të dhënat për Prokuroritë Themelore ndaras, vërejmë se në këtë numër të lartë ndikojnë Prokuroritë Themelore në bazë të performances së tyre. Për 2016 Prokuroria e Mitrovicës ka numrin më të lartë të indeksit të lëndëve të grumbulluara, e pasuar nga Prokuroria Speciale, Prokuroria e Prishtinës dhe ajo e Ferizajit. Siç e kemi theksuar më lartë, vlera e lartë e këtij numri tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rastit, duke bërë që sistemi të vonojë në trajtimin e lëndëve. Mitrovica dhe Prokuroria Speciale kishin numrin më të madh të ditëve për trajtimin e lëndëve, gjegjësisht 608 ditë për Specialen dhe 1175 për Mitrovicën.


Kur numri është më i lartë se 1.0, Prokuroria nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese duke bërë që lëndët e reja që hyjnë në sistem të vazhdojnë të barten dhe të presin për trajtim për një kohë të caktuar në të ardhmen. Prokuroria Speciale ka pasur 184 lëndë në fillim të periudhës kurse ka trajtuar 84 lëndë, derisa ajo e Mitrovicës ka pasur 159 lëndë dhe ka trajtuar 59 prej tyre. Në anën tjetër, Gjilani ka pasur 17 lëndë dhe ka trajtuar 167 duke vepruar kështu me një normë shumë të lartë të qarkullimit dhe duke menaxhuar mirë edhe fluksin e lëndëve të reja.

\* Sa më e madhe të jetë norma e qarkullimit të lëndëve, aq më shumë shkurtohet koha brenda së cilës sistemi jep drejtësi, pra koha për përfundimin e lëndëve.

## Prokuroritë Themelore si dhe Prokuroria Speciale Statistikat antikorrupsion për lëndë Janar – Dhjetor 2016


Lëvizja FOL shpreson se statistikat e mësipërme do t'i kontribuojnë vetë Prokurorive për të parë punën e tyre dhe për të ngritur nivelin e performancës.

Nga 915 lëndë/raste në punë që kanë qenë për vitin 2016, gjithsej 2250 persona kanë pritur trajtim nga Prokuroritë. Për shkak të specifikave të punës së Prokurorisë ne kemi përdorur personat në vend të lëndëve/rasteve për të matur performancën e Prokurorisë. Në grafikët e mëposhtëm do t'i paraqesim statistikat e kundërkorrupsionit, të shprehura në lëndë/raste.




Grafiku 1

## Prokuroria Themelore Prishtinë




Grafiku 2


## Prokuroria Themelore Ferizaj




Grafiku 3




Grafiku 4



Grafiku 5




Grafiku 6




Grafiku 7





Grafiku 8



Grafiku 9

# Përfundim

Ky është raporti i parë i këtij lloji nga Lëvizja FOL i cili mat me numra dhe formula të sakta performancën e Prokurorisë në luftën kundërkorrupsionit.

Duke qenë një organizatë me përvojë të gjatë në luftën kundërkorrupsionit, Lëvizja FOL ndan shqetësimin për nivelin e lartë të korrupsionit qeveritar dhe performancën e dobët të Prokurorisë në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Edhe përkundër rezultateve të mira për vitin 2016 nga prokuroria në trajtimin e më shumë lëndëve krahasuar me lëndët e pranuar, shqetësim mbetet hetimi i korrupsionit të nivelit të lartë.

Korrupsioni duhet të hetohet dhe të dënohet në çdo nivel, por prokurorët duhet të gjejnë guximin që të hetojnë vepra të mëdha të korrupsionit nga zyrtarë të nivelit të lartë duke mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzat të bazuara.

Përtej numrave është thirrje për të parë punën e Prokurorisë përtej statistikave të pakuptueshme. Raporti gjen se Prokuroria ka pasur performancë të mirë, në përgjithësi, në luftën kundërkorrupsionit për vitin 2016 në kuptimin që ka arritur të trajtojë më shumë lëndë se sa ka pranuar.

Por numrat nuk arrijnë të na tregojnë se sa mirë janë përgatitur kallëzimet penale të dorëzuara në Prokurori dhe sa mirë janë përgatitura dhe sa të bazuara kanë qenë pastaj aktakuzat, e sidomos sa mirë kanë qenë të mbrojtura këto aktakuzat para gjykatësive. Raporti gjithashtu nuk arrin të na tregojë nëse aktakuzat qëllimisht janë përgatitur si të pabazuara, nëse ato kanë qenë të ndikuara nga politika apo ndoshta edhe nga veprat korruptive brenda Prokurorisë.

Ajo që ky raport tregon është se Prokuroria ka treguar sukses në trajtimin e lëndëve kundërkorrupsionit, duke trajtuar një numër të madh të tyre dhe duke mos e vonuar drejtësinë.

Raporti e thjeshtëson të kuptuarit e performancës së Prokurorisë duke i përkthyer dhe analizuar numrat në fjalë që kanë kuptim.

Në këtë raport Lëvizja FOL është përpjekur të ofrojë një pasqyrë për Prokurorinë që ajo ta shohë vetveten, ta masë vetveten dhe ta përmirësojë vetveten.

Prishtina dhe Gjilani kanë shumëçka për t'i mësuar të gjitha Prokurorive tjera sa i përket menaxhimit të fluksit të lëndëve por edhe në lidhje me eliminimin e lëndëve të mbetura.

Besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë nuk fitohet për një ditë. Për afër dy dekada qytetarët janë ndier të zhgënjyer me punën e Prokurorisë duke pritur me vite të tëra që korrupsioni të hetohet. Prandaj kërkohet një punë shumë e madhe për të fituar besimin.

Ky raport është vetëm një nga përpjekjet për t'i sjellur qytetarët më afër drejtësisë përmes shpjegimit të punës së Prokurorive.

Perceptimi mund të luftohet vetëm përmes argumenteve të bazuara në fakte.

Ky raport bën pikërisht këtë - në njërën anë u ndihmon qytetarëve që ta kuptojnë punën e prokurorisë në luftën kundërkorrupsionit, kurse në anën tjetër i ndihmon Prokurorisë që ta rrisë performancën.

Lëvizja FOL do të publikojë raporte periodike për punën e Prokurorive në muajt në vazhdim.

Raportet e ardhshme do të përfshijnë edhe performancën tremujore por edhe një analizë më të gjerë me indikatorë shtesë.

# Bibliografia

European Commission (2016, May 4). <http://europa.eu/rapid/search.htm>. Retrieved March 02, 2017, from <http://europa.eu>: [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-16-1626\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1626_en.htm)

CEPEJ (2015). CEPEJ Guidelines.

COMMISSION, E. (2015). COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT. KOSOVO\* 2015 REPORT. EUROPEAN COMMISSION. Brussels: EUROPEAN COMMISSION.

Dakolias, M. (1999). Court Performance Around the World: A Comparative Perspective. Volumes 23-430.

Dakolias, M. (2014, 82). Court Performance Around the World: A Comparative Perspective. Yale Human Rights and Development Journal, Volume 2(Issue 1 Yale Human Rights and Development Journal), 57.

Department of State, U. (2015). Kosovo Human Rights Report.

Hall, D. H., & Keilitz, I. (2012). Global Measures of Court Performance. Discussion Draft Version 3. International Framework for Court Excellence.

Hall, D. H., & Keilitz, I. (2012). Global Measures of Court Performance. Discussion Draft Version 3 .

Hodzic, A., & Georg, S. (n.d.). What can be said on clearance rate and disposition time (and some more)?

KGJK. (2013). Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra.

KGJK. (2016). Raporti vjetor për Grupin e veprave penale që lidhen me korrupsion.

Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës . Korrupsioni Zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

KPK. (2016). Raporti Vjetor për grupin e veprave penale që lidhen me Korrupsion.

Maliqi, A. (2016). Intervistë rreth strategjisë për reduktimin e lëndëve antikorrupsion në gjykata.

Prokurori i Shtetit, Z. (2015). Strategjia - Prioritetet e Prokurorive Themelore në Kosovë në ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe reduktimin e numrit të lëndëve.

UNDP - Kosove. (2016). Pulsi Publik XI. Anketë, UNDP - Kosovë, Prishtinë.

Uslaner, E. M. (2008). Corruption, Inequality, and the Rule of Law. New York: Cambridge University Press.

## Shënime për prokuroritë

- Tek grupi i kapitullit të veprave penale të korrupsionit, tek statistikat e derguara nga prokuroria, ka vepra të cilat nuk i perkasin këtij grupi të veprave, psh: shperlarja e parave, prodhim i ndaluar, keqperdorim i autorizimeve ekonomike etc.
- Prokuroria duhet me i publiku edhe statistikat se sa aktakuza i jane hudhur poshte nga ana e gjykatave. Keto statistika mund te tregojnë për performancën e prokuroreve ne pergatitjen aktakuzave, nëse ato janë të bazuaranë fakte dhe dëshmi të qëndrueshme.
- Sistemi i mbledhjes së informatave është manual, duke bërë që shpesh numrat të mos përputhen mes veti, rrjedhimisht duke shkaktuar paqartësi se çfarë ka ndodhur me lëndë të caktuara

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).





